



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M
P Ë R
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR, "PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE
SHQIPTARE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30
QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 64, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 ka caktuar datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, me shkronja nistore "P.R.D.SH", nëpërmjet Kryetarit të saj, z.Krenar Rryçi, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019, administruar me nr.2308 prot., datë 11.04.2019.



Kërkesa e paraqitur nga "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Nga analiza e dokumentacionit paraqitur bashkëlidhur kërkesës, evidentohet respektimi në mënyrë të plotë, në formë dhe përmbajtje, i kërkesave të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Konkretisht është paraqitur:

- Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 11.04.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet se "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", me iniciale "P.R.D.SH", dhe me Kryetar z.Krenar Rryçi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- specimeni i vulës së partisë;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (zj.Santiliana Muho);
- emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z.Ermir Rryçi);

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse dhe konstatimit se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", me kryetar z.Krenar Rryçi, dhe shkronja nistore "P.R.D.SH", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Nr.196 i Vendimit Data 23.04.2019 Ora 13:00 e Vendimit

Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

